

## Zgjedhja e presidentit të republikës 2024

### Zgjedhja e presidentit të republikës 2024

Qytetarët e Finlandës e zgjedhin presidentin e tyre në çdo gjashtë vjet. Në zgjedhjet presidenciale mund të votohet dy herë.

Nëse njëri nga kandidatët merr më shumë se gjysmën e votave gjatë votimit të parë, ai zgjidhet drejtpërdrejt president.

Gjatë zgjedhjeve presidenciale, votimi i dytë bëhet nëse asnjëri nga kandidat nuk merr më shumë se gjysmën e votave në votimin e parë.

Votimi i dytë organizohet ndërmjet dy kandidatëve që në votimin e parë kanë marrë vota më shumë se të tjerët.

### Votimi i parë:

Dita e zgjedhjeve është e diel me 28.1.2024.

Votimi i parakohshëm në Finlandë është me 17.–  
23.1.2024.

Votimi i parakohshëm jashtë Finlandës është me 17.–  
20.1.2024.

### Mundësia e votimit të dytë:

Dita e zgjedhjeve është e diel me 11.2.2024.

Votimi i parakohshëm në Finlandë është me 31.1.–  
6.2.2024.

Votimi i parakohshëm jashtë Finlandës është me 31.1.–  
3.2.2024.

### Detyrat e presidentit

Presidenti drejton politikën e jashtme të Finlandës së bashku me qeverinë.

Presidenti i konfirmon ligjet të cilat i ka miratuar parlamenti.

Presidenti emëron kryeministrin dhe ministrat e tjerë në detyrat e tyre.

Përveç kësaj, ai emëron gjyqtarët si dhe disa nga zyrtarët e lartë.

Ai vendos për luftën dhe paqen. Megjithatë, për këtë vendim presidentit i duhet pëlqimi i parlamentit.

### **Kush mund të votojë?**

Ke mundësi votimi në zgjedhjet presidenciale,

- nëse je shtetas i Finlandës dhe
- nëse ke mbushur 18 vjeç deri me datën 28.1.2024.

### **Kush mund të votohet?**

Partitë dhe shoqatat e votuesve mund të propozojnë kandidatë për zgjedhjet presidenciale. Kandidati duhet të jetë shtetas i Finlandës i lindur këtu. Kandidatët presidencialë garojnë në nivel të vendit, kështu që mund të votohet secili kandidat.

Secili kandidat ka numrin e tij si kandidat. Numrat e kandidatëve ekspozohen në qendrat e votimit dhe në kabinat e votimit. Informacione për kandidatët mund të merren p.sh. nga gazetatat, televizioni dhe interneti.

### **Njoftimi për të drejtën e votës**

Nëse ke të drejtë votimi, ty të dërgohet një letër në shtëpi. Në letër ka dy njoftime për të drejtën e votës.

Njoftimi për të drejtën e votës, mund të dërgohet me postë elektronike, nëse ke aktivizuar shërbimin Suomi.fi. Suomi.fi është një shërbim i Agjencisë së informacioneve dixhitale dhe të popullsisë (Digi- ja väestötietovirasto). Lexo më shumë në adresën [www.suomi.fi/viestit](http://www.suomi.fi/viestit).

Zgjidh për të votuar në ditën e zgjedhjeve apo me votim të parakohshëm. Nëse voton në ditën e zgjedhjeve, lexoi të dhënat për qendrën tënde të votimit në njoftimin e dërguar për të drejtën e votës.

Nëse voton paraprakisht, mund të votohet në çdo vend të caktuar për votim të parakohshëm. Në njoftimin për të drejtën e votës është lista e vendeve të votimit paraprak në zonën tuaj.

Nuk ke nevojë për të dërguar njoftimin për të drejtën e votës në qendrën e votimit. Mjafton nëse ke dokumentin e identifikimit personal.

## **Votimi në shtëpi**

Nëse je i sëmurë ose e ke jashtëzakonisht të vështirë për të shkuar në qendrën e votimit për të votuar atje, ke mundësi për të votuar paraprakisht në shtëpi.

Regjistrohu për votimin në shtëpi, në këshillin qendror zgjedhor të komunës suaj **deri në datën 16.1.2024 ora 16:00**.

Numri i telefonit është në njoftimin për të drejtën e votës. Nga Këshillit qendror i zgjedhjeve mund të kërkohen më shumë informacione rreth votimit në shtëpi.

Nëse për zgjedhjet presidenciale mbahet edhe votimi i dytë, regjistrimi i bërë për votimin në shtëpi, do të jetë poashtu i vlefshëm edhe për votimin e dytë.

## **Kështu voton paraprakisht**

Ke mundësi për të votuar paraprakisht në zgjedhjet presidenciale në çdo vend të votimit të parakohshëm.

**Votimi paraprak në Finlandë është me 17.–23.1.2024.**

**Votimi paraprak jashtë Finlandës është me 17.–20.1.2024.**

Nëse në zgjedhjet presidenciale mbahet votimi i dytë, votimi mund të bëhet në ditën e zgjedhjeve ose paraprakisht.

**Votimi i parakohshëm për herën e dytë në Finlandë është me 31.1.–6.2.2024.**

**Votimi i parakohshëm për herën e dytë jashtë Finlandës është me 31.1.–3.2.2024.**

Merr me vete për votim një dokument identifikues me foto, për shembull pasaportën, kartën e identitetit personal ose patentën e shoferit.

**Vepra kështu në qendrën e votimit të parakohshëm:**

**1. Trego dokumentin identifikues personal zyrtarit zgjedhor.**

Zyrtari do e kontrollojë atë dhe do të japë një fletë votimi.

**2. Shko në kabinën e votimit.**

Shkruaje qartë në fletëvotim numrin e kandidatit, për të cilin po voton.

Mos shkruaj asgjë tjetër në fletëvotim.

Numrat e kandidatëve shihen në listën e kandidatëve që është në murin e kabinës së votimit.

**3. Paloje fletën e votimit në gjysmë, ashtu që askush të mos e shohë numrin.**

**4. Kthehu te zyrtari i zgjedhjeve.**

Ai do të vulosë fletën e votimit dhe do të japë një zarf me ngjyrë kafe.

**5. Vendose fletën e votimit të vulosur në zarf dhe mylle kapakun e zarfit me ngjitësin e tij.**

**6. Zyrtari zgjedhor do të kërkojë për të nënshkruar formularin.**

Duke nënshkruar, po konfirmon se e ke plotësuar vetë fletën e votimit, ke marrë vulën në të dhe e ke mbyllur atë në zarfin e dhënë.

**7. Më në fund, zyrtari vendos zarfin ngjyrë kafe dhe formularin në zarfin me ngjyrë të verdhë.**

Zyrtari e mbyll me ngjitës zarfin me ngjyrë të verdhë. Zarfi i dorëzohet këshillit qendror zgjedhor të komunës suaj.

## **Kështu voton në ditën e zgjedhjeve**

**Dita e zgjedhjeve është e diel me 28.1.2024.**

**Dita e zgjedhjeve të mundshme për herën e dytë është e diel me 11.2.2024.**

**Në ditën e zgjedhjeve qendrat e votimit janë të hapura nga ora 9–20.**

Mund të votohet vetëm në qendrën e votimit që është shënuar në njoftimin për të drejtën tënde për të votuar.

Merr me vete për votim dokumentin identifikues me foto, për shembull pasaportën, kartën identitetit personal ose patentën e shoferit.

### **Vepra kështu në vendin e votimit:**

#### **1. Tregoi zyrtarit zgjedhor dokumentin e identifikimit.**

Zyrtari do të kontrollojë atë, do të gjejë emrin tuaj në listën zgjedhore dhe do të japë fletën e votimit.

#### **2. Shko në kabinën e votimit.**

Shkruaj qartë në fletëvotim numrin e kandidatit për të cilin po voton.

Mos shëno asgjë tjetër në fletëvotim.

Numrat e kandidatëve shihen në listën e kandidatëve në murin e kabinës së votimit.

#### **3. Paloje fletën e votimit në gjysmë, ashtu që askush të mos e shohë numrin.**

#### **4. Kthehu te zyrtari i zgjedhjeve.**

Ai vulos fletën e votimit.

#### **5. Hidhe fletën e votimit të vulosur në kutinë e votimit.**

## **Nga kush merret ndihmë?**

### **Zyrtarët zgjedhorë do të këshillojnë dhe do të ndihmojnë ty në qendrën e votimit.**

Qendra e votimit ka edhe asistentin zgjedhor. Mund të kërkohet ndihma e tij në dhomën e votimit nëse nuk je në gjendje për të shkruar vetë numrin e kandidatit në fletëvotim.

Si asistent zgjedhor mund të veprojnë edhe personi, të cilin vetë e ke zgjedhur. Ai mund të jetë, për shembull, një familjar ose një i afërm. Megjithatë, asistenti zgjedhor nuk mund të jetë kandidat ose i afërm i kandidatit.

Asistenti zgjedhor nuk lejohet të tregojë askujt se për kë ke votuar.

-

## **Fshehtësia e zgjedhjes**

Secili vendos vetë, nëse dëshiron të votojë dhe për kë do të votojë.

Fshehtësia e zgjedhjes do të thotë, që ti nuk duhet treguar askujt, se për kë po voton.

Për shkak të fshehtësisë së zgjedhjes, ti e plotëson fletën e votimit në kabinën e votimit.

-

## **Voton në zgjedhjet presidenciale! Kështu ndikoni se kush do të jetë president për gjashtë vitet e ardhshme.**

Në këtë udhëzues tregohet në gjuhën e qartë për votimin dhe zgjedhjet presidenciale 2024.

Lexo më shumë informacione në adresën: [www.vaalit.fi](http://www.vaalit.fi)

Pyetje për zgjedhjet dhe votimin mund të bëhen edhe nga shërbimi i ministrisë së drejtësisë në numrin 0800 9 4770.

Pyetjet mund të dërgohen edhe në mesazhin me WhatsApp në numrin 050 438 8730.